



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2631, datë 29.10.2015

Për

“Përfundimin e këshillimit publik të dokumentit “Ndryshime në Planin Kombëtar të Numeracionit” dhe:

- **Miratimin e ndryshimeve në Planin Kombëtar të Numeracionit,**
- **Miratimin e ndryshimeve në Rregulloren për Caktimin dhe Përdorimin e Numrave dhe Serive Numerike”.**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 29.10.2015, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin Nr. 9918 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, datë 19.05.2008, i ndryshuar, Ligjin Nr. 8480 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, datë 27. 05.1999 dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Përfundimin e këshillimit publik të dokumentit “Ndryshime në Planin Kombëtar të Numeracionit” dhe:

- **Miratimin e ndryshimeve në Planin Kombëtar të Numeracionit,**
- **Miratimin e ndryshimeve në Rregulloren për Caktimin dhe Përdorimin e Numrave dhe Serive Numerike”.**

BAZA LIGJORE:

1. Ligji Nr. 8485 “Kodi i procedurave administrative”, datë 12.05.1999;
2. Ligji 115/2014 "Për ndarjen administrativo - territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë";

3. Gërma e), pika 3 e nenit 7, gërma i) e nenit 8, neni 80 dhe neni 110 të Ligjit Nr.9918 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, datë 19.05.2008, i ndryshuar, (në vijim Ligji 9918);
4. Vendim Nr.932, datë 11.08.2009 i Këshillit Drejtues të AKEP për miratimin e “Planit Kombëtar të Numeracionit”, ndryshuar me VKD Nr. 2350, datë 13.09.2013 për “Miratimin e disa ndryshimeve në Planin Kombëtar të Numeracionit”;
5. Rregullore Nr.10, për “Caktimin dhe Përdorimin e Numrave dhe Serive Numerike dhe Planit Kombëtar të Numeracionit”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 932 datë 11.08.2009, e ndryshuar me VKD Nr. 2394, datë 05. 12. 2013;
6. Vendim i KD të AKEP Nr.2613, datë 10.09.2015 për “Miratimin për këshillim publik të dokumentit “Ndryshime në Planin Kombëtar të Numeracionit””;
7. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr. 2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

1. Relacioni shpjegues mbi këshillimin publik të dokumentit “Ndryshime në Planin Kombëtar të Numeracionit” dhe dokumenti qëndrimi i AKEP mbi komentet e operatorëve;
2. Dokumenti për këshillim publik “Ndryshime në Planin Kombëtar të Numeracionit”, miratuar me VKD Nr. 2613, datë 10.09.2015;
3. Projekt-Vendimi përkatës,

si dhe diskutimet në mbledhje mbi çështjen;

Duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N s e :

1. Dokumenti për këshillim publik “Ndryshime në Planin Kombëtar të Numeracionit” miratuar me VKD Nr. 2613, datë 10.09.2015, është publikuar në faqen web të AKEP www.akep.al në Rubrikën “Konsultime” nga data 10.09.2015 deri në datën 20.10.2015 si dhe në rubrikën “Njoftime”.
2. Në lidhje me çështjet e ngritura nga AKEP në dokumentin e Këshillimit Publik, u paraqitën komente dhe qëndrime nga:
 - Albtelecom sh.a me shkresë Nr. 8169, datë 20.10.2015 (prot. i AKEP nr. 1054/3 datë 22.10.2015).

3. Grupi i Punës pasi ka shqyrtuar komentet dhe qëndrimet e sipërmarrësit të sipërcituar, ka përgatitur dokumentin “*Komentet e operatorëve dhe qëndrimi i AKEP*”, në përputhje me çështjet e ngritura në dokumentin për këshillim publik.
4. Grupi i punës vëren se dy janë problemet kryesore të ngritura në këtë këshillim publik nga sipërmarrësi Albtelecom sh.a.
 - a) që të theksohet dhe qartësohet akoma më shumë propozimi i AKEP, për ruajtjen e praktikave të ndjekura deri tani, sipas të cilave seritë numerike do të vazhdojnë të jepen (alokohen) sipas zonave gjeografike të NDC përkatëse, ku do t’i jepet shërbimi përdoruesit fundor si në rastin kur seritë numerike i alokohen operatorit nga AKEP ashtu edhe në rastin kur operatori jep në përdorim (alokon) numrin tek abonenti dhe
 - b) që të zgjasë me 1 vit (01.01.2017) heqja e plotë e informacionit gjeografik nga Plani Kombëtar i Numeracionit, në menyrë që të mund të bëjë përgatitjet përkatëse (studimet dhe testet 'laboratorike'), implementimet e tabelave të rutimit, matricave, përditësimet e sistemeve dhe automatizimin e proceseve lidhur me kalimin në një zonë të vetme gjeografike si dhe zgjerimin e zonës së portabilitetit të numrit të operatorit.

Qëndrimi i AKEP për këto çështje është sqaruar në dokumentin e komenteve dhe qëndrimeve duke propozuar ruajtjen e praktikave aktuale (sipas NDC) në alokimin parësor dhe si afat për zbatimin e ndryshimeve në PKN datën 01.07.2016.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në Ligjin Nr. 9918, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, datë 19.05.2008, i ndryshuar dhe qëllimin rregullator që ndryshimet e propozuara në Planin Kombëtar të Numracionit, t’u përgjigjen:

- Ndryshimeve të mëdha demografike që kanë ndodhur në Shqipëri dekadën e fundit, veçanërisht rritja e madhe e popullimit të zonave urbane si Tirana, Durrësi etj;
- Zhvillimit të rrjeteve të gjeneratës së re, nëpërmjet të cilave bëhet i mundur ofrimi i shërbimeve broadband dhe nëpërmjet saj reflektimi i ndikimeve në PKN të migrimit të rrjeteve TDM në rrjetet NGN.

V E N D O S:

1. Të miratojë përfundimin e këshillimit publik të dokumentit “Ndryshime në Planin Kombëtar të Numeracionit”, me komentet e operatorëve dhe qëndrimin e AKEP sipas dokumentit bashkëlidhur;
2. Të miratojë ndryshimet në Planin Kombëtar të Numeracionit, sipas Ankesit 1 bashkëlidhur këtij vendimi;
3. Të miratojë ndryshimet në Rregulloren Nr.10, për “Caktimin dhe Përdorimin e Numrave dhe Serive Numerike” të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 932 datë 11.08.2009, e ndryshuar me VKD Nr. 2394, datë 05. 12. 2013, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi;

4. Aplikimi i ndryshimeve në Planin Kombëtar të Numeracionit fillon nga data 01.07.2016;
5. Implementimi i këtyre ndryshimeve në PKN, lidhur me ndryshimet në PKN si dhe numër formimin, të shoqërohet me një fushatë publicitare. Fushata do të bëhet nëpërmjet mjeteve të informimit publik si Radio, Televizion, botime periodike shtypi të shkruar etj.
6. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Anila DENAJ** _____
3. **Ketrin TOPÇIU** _____
4. **Klarina ALLUSHI** _____

Aneks 1:

Ndryshimet në Planin Kombëtar të Numeracionit:

- **RAJONI GJEOGRAFIK I NUMERACIONIT DHE DETAJIMI I NDC-ve BRENDA TIJ**
- **NUMËRFORMIMI**

Dokumenti:

NDRYSHIME NË RREGULLOREN NR.10, PËR “CAKTIMIN DHE PËRDORIMIN E NUMRAVE DHE SERIVE NUMERIKE” TË MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT DREJTUES TË AKEP NR. 932 DATË 11.08.2009, E NDRYSHUAR ME VKD NR. 2394, DATË 05. 12. 2013

Komentet e pjesëmarrësve dhe qëndrimi i AKEP në këshillimin publik të dokumentit “Ndryshime në Planin Kombëtar të Numeracionit”

Në zbatim të Neni 7, shkronja 3, germa e), neni 8, germa i), neni 80 dhe neni 110 të Ligjit nr.9918, datë 19.05.2008 ”Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, (në vijim Ligji 9918) Vendim Nr.2613, datë 10.09.2015 për “Miratimin për këshillim publik të dokumentit “Ndryshime në Planin Kombëtar të Numeracionit”, AKEP kreu një këshillim publik me palët e interesuara.

Në përfundim të këtij këshillimi publik, në AKEP u depozituan komente nga palët e interesuara si më poshtë:

- Albtelecom sh.a shkresa nr.8169 date 20.10.2015 (prot. i AKEP nr. 1054/3 datë 22.10.2015).

Më poshtë paraqiten komentet e të interesuarve dhe qëndrimi përkatës i AKEP.

Komenti i Albtelecom:

1. Te theksohet dhe qartësohet akoma me shume propozimi i AKEP per ruajtjen e praktikave te ndjekura deritani sipas te cilave serite numerike do te vazhdojne te jepen (alokohen) sipas zonave gjeografike te NDC perkatese ku do ti jepet sherbimi perdoruesit fundor, si ne rastin kur serite numerike i alokohen operatorit nga AKEP ashtu edhe ne rastin kur operatori jep ne perdorim (alokon) numrin tek abonenti, kjo te pakten deri me 01.01.2017.

Qëndrimi i AKEP:

Ky eshte edhe propozimi i AKEP e ka beret e qarte edhe ne dokumentin e keshillimit publik duke propozuar ruajtjen e praktikave aktuale (siapas NDC) ne alokimin paresor dhe jane dhene edhe shembuj praktike. Sa i perket alokimit dytesor (caktimi i numrit nga operatori per pajtimtarin) AKEP do te kerkoje qe te respektohet e njejta gje.

Komenti i Albtelecom:

2. Te zgjase me 1 vit (01.01.2017) heqjen e plote te informacionit gjeografik nga Plani Kombetar i Numeracionit ne menyre qe te mund te beje pergatitjet perkatese, (studimet dhe testet 'laboratorike') dhe implementitnet e tabelave te rutimit, matricave, perditesimet e sistemeve dhe automatizimin e proceseve lidhurme kalimin ne nje zone te vetme gjeografike dhe lidhur me zgjerimin e zones se portabilitetit te numrit te operatorit. Kjo eshte e domosdoshme te pakten per te minimizuar qofte kostot qe shkaktohen per te perballuar keto lloj ndryshimesh ashtu edhe per te evituar pasoja te pakthyeshme ne lidhje me problemet e mundshme te rrugezimit/rrugezimeve si ne lidhje me sistemet brenda nje operatori apo ndermjet operateve me njeri tjetrin ashtu edhe ne lidhje me

pajtimtaret ne teresi. Kjo kohe tranzitore duhet te marre ne konsiderate gjithashtu edhe kohen e nevojshme per negocimin dhe arritjen e dakortesise me kontraktoret e sistemeve per perditesimin e sistemeve dhe automatizimin e proceseve te nevojshme. Perjashtim nga shtyrja ne kohe, do te bejne vetem rastet kur abonenti do te kerkoje transferimin e numrit brenda te njejtir rajon, proces te cilin Albtelecom do te vazhdoje ta kryeje manualisht deri ne perditesimin e sistemeve dhe kryerjes se konfigurimeve te reja dhe implementimit te matricave te reja te komunitmit dhe rrugezimit te thirrjeve. Kjo periudhe do mund tesherbeje edhe per perditesimin erreguUoreve perkatese mbi perdorimin dhe alokimin e numeracionit si dhe mbi procesin e portabilitetit te numrit. Gjate kesaj periudhe, edhe operatoret do te kene mundesi te fitojne te njejtin kuptim dhe te pergatiten mbi ndryshimet e pritshme por nderkohe edhe konsumatoret do mund te familjarizohen me kuptimin e ri te numeracionit gjeografik dhe numerformimin e tij.

Qendrimi i AKEP:

AKEP duke vleresuar kerkesen e Albtelecom dhe ne vleresim te argumentave te dhene pre tyre propozon si date te fillimit te zbatimit te ndryshimeve ne PKN daten 01.07.2016.